



# Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

MALESE-IZLAZNA-OUTGOING  
 REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA  
 QEVERIA E KOSOVES / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
 Ministerstvo Lokalne Samouprave i Administracije  
 Ministry of Local Government Administration

Nr. 020-1133/4  
 Data 11.10.2018

Për :	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovë Anton Shala, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjakovës	
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes: <i>pi</i>	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Xhevat Tafa, u.d i Drejtorit të Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL	Datë: 05.10.2018
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Gjakovës	Nr.020-1133
Lloji i aktit:	<input type="checkbox"/> Vendim	

I nderuar Kryetar,  
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-40 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim nr. 413/01-27425/18 për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit komunal ndërkombëtar në mes komunës së Gjakovës dhe Fort Dooge. Lova USA
I miratuar më datë: 26.09.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 03.10.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si me sipër, vlerëson se akti i komunës *në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.* Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.





# Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E TVLADË  
GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije  
Ministry of Local Government Administration

Nr. Br. 020-1133/4  
No. VI

Data Datum 11.10.2018  
Date

Za:	Ardian Gjini, gradonačelnik Opštine Đakovica Anton Shala, predsedavajući Skupštine opštine Đakovica	
Cc:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a	
Od:	Xhevat Tafa, v.d. rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština/ MALS	Datum, 05.10.2018.
Predmet:	Potvrda zakonitosti akata opštine Đakovica	Br.020-1133
Vrsta akta:	<input type="checkbox"/> Odluka Skupštine opštine	

Poštovani gradonačelnice,  
Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-05 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 413/01-27425/18 za usvajanje Sporazuma o razumevanju međunarodne opštinske saradnje između opštine Đakovica i Fort Dooge. Iowa USA
Usvojene dana, 26.09.2018. godine,
Predložene za razmatranje u MALS-u dana, 03.10.2018. godine,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni efekat.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA /  
REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



**Kuvendi i Komunës - Gjakovë**

01 Nr. 413/01-2742/2018

Dt. 26.09.2018

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12, Pika (d), nenit 40 pika (f) të Ligjit 034-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenit 18 të Ligjit nr.04/L-010 Për Bashkëpunim ndër komunal në mbledhjen e mbajtur me dt. 26.09.2018, pas diskutimeve lidhur me pikën e 7-të të rendit të ditës: Të Ndryshme, lidhur me miratimin e marrëveshjes së Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar me Komunën Fort Dodge, Iowa USA, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet marrëveshjes së Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Gjakovës me Komunën Fort Dodge, Iowa USA.
2. Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini është përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes për bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar me Komunën Fort Dodge, Iowa USA.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
4. Vendimi iu dërgohet:
  - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini,
  - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
  - Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës
  - Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,

Anton Shafa



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI  
KOMUNAL NDËRKOMBËTAR



ndërmjet

Komunës së Gjakovës në Republikën e Kosovës dhe  
Komunës së Fort Dodge në Iowa, Shtetet e Bashkuara të Amerikës

për bashkëpunim në fushën e:

**“Administratës Publike, Ekonomisë, Kulturës dhe Arsimit”**

DUKE KONSIDERUAR lidhjen ekzistuese të miqësisë dhe bashkëpunimi në fushat e administratës publike, kulturës, ekonomisë dhe arsimit,

DUKE U BAZUAR në besimin se forcimi i dialogut ndërmjet këtyre Qyteteve është një hap fundamental drejtë një zhvillimi dhe promovimin e lidhjeve ekonomike, akademike dhe kulturore ndërmjet palëve,

DUKE PRANUAR që pjesëmarrja në një aktivitet të tillë është vullnetare dhe që përfshinë bashkëpunim dypalësh mbi baza të drejta,



DUKE JU REFERUAR Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 neni 17 (k) dhe 30, Ligji për Bashkëpunimin Ndërkomunal Nr. 04/L-010, Ligji për Arbitrazhin Nr. 02/L-75

Kanë rënë dakord mbi arritjen e kësaj marrëveshje bashkëpunimi të mëposhtme:

## Neni 1 QËLLIMI

Qëllimi i kësaj Marrëveshje bashkëpunimi është thellimi i bashkëpunimit mes dy Komunave në fushën e administratës publike, kulturës, ekonomisë dhe arsimit, ashtu që të definohen qartë caqet, objektivat dhe përgjegjësitë përkatëse të secilit organ veç e veç. Dhe si i tillë bashkëpunimi do të zbatohet mbi baza të njëjta reciprociteti dhe përfitimi të dyanshëm.

## Neni 2 FUSHAT E BASHKËPUNIMIT

- I. Bashkëpunimi do të bëhet në fushën e zhvillimit të administratës publike, ekonomisë, kulturës dhe arsimit, duke ofruar dhe pranuar shërbime në fushën e administratës publike, kulturës, ekonomisë dhe arsimit:
  - a. Bashkëpunimi në fushën e **administratës publike** – të dy palët, do të angazhohen në inkurajimin e projekteve të përbashkëta dhe shkëmbimin e eksperiencave në sferën e qeverisjes elektronike dhe digjitalizimin e administratës publike me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve komunale në dobi të qytetarëve;
  - b. Bashkëpunimi në fushën e **ekonomisë** – të dy palët, përmes mekanizmave ekonomike në detyrë, do të mbështesin dhe forcojnë bashkëpunimet në promovimin e investimeve, tregtisë dhe të zhvillimit ekonomik ndërmjet ndërmarrjeve të të dy qyteteve;
  - c. Bashkëpunimi në fushën e **kulturës** – të dy palët do të bashkëpunojnë në promovimin mbështetjen e aktiviteteve dhe projekteve kulturore, si dhe do të udhëheqin të gjitha aktivitetet që do të lehtësojnë shkëmbimet ndërmjet organizatave kulturore të të dy qyteteve;
  - d. Bashkëpunimi në fushën e **arsimit** – të dy palët do të bashkëpunojnë në promovimin e miqësisë internacionale duke stimuluar dhe zhvilluar aktivitete edukative ndërkulturore dhe projekteve të rinjve dhe studentëve të Gjakovës dhe Fort Dodge. Në këtë kontest, qyteti i Gjakovës dhe qyteti i Fort Dodge do t'i mbështesin shkëmbimin e studentëve dhe profesorëve të universiteteve, shkollave

të mesme dhe qendrave tera hulumtuese të të dy qyteteve.

### **Neni 3**

#### **TE DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE KONTRAKTUESE**

1. Marrëveshja e bashkëpunimit do të kryhet në përputhje me ligjet në fuqi të të dyja vendeve në bazë të detyrimeve përkatëse që merren nga të dy palët sipas të drejtës ndërkombëtare.;
2. Marrëveshjet e lidhura nga komunat në kuadër të bashkëpunimit komunal ndërkombëtar janë vetëm të natyrës administrative dhe teknike.
3. Në kuadër të këtij bashkëpunimit komunal ndërkombëtar, komunat nuk kanë të drejtë të heqin dorë nga kompetencat e tyre të përcaktuara me ligj, t'ia delegojnë një komune ose autoriteti publik të huaj ushtrimin e kompetencave të veta si dhe t'ia lejojnë komunës ose autoritetit publik të huaj ushtrimin e çfarëdo pushteti ekzekutiv, administrativ, legjislativ në territoret e të dy shteteve ose që synon të ketë efekt të tillë në territoret e të dy shteteve.

### **Neni 4**

#### **BURIMET FINANCIARE PËR REALIZIMIN E BASHKËPUNIMIT**

Të dy palët pajtohen se çdo aktivitet që synon zbatimin e kësaj Marrëveshje nuk do të implikon pagesa shtesë nga sistemi publik financave, duke u bazuar në ligjin për financa publike në fuqi, por do të mbulohet nga institucionet e propozuara.

### **Neni 5**

#### **KOORDINIMI NDËRMJET PALËVE**

Palët në këtë marrëveshje bien dakord për të formuar një grup të përbashkët, i cili është përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes në fjalë.

### **Neni 6**

#### **DETYRIME TJERA**

1. Palët marrin masat e nevojshme për të realizuar veprimtaritë në të gjitha fazat e zbatimit nëpërmjet nënshkrimit të kësaj marrëveshje dhe nënshkrimit të akteve tjera të mëvonshme që dalin nga ky bashkëpunim reciprok e që kanë të bëjnë me fushën e zhvillimit të administratës publike, ekonomisë, kulturës dhe arsimit.
2. Palët caktojnë një përfaqësues për ndjekjen dhe realizimin e bashkëpunimit të përcaktuar me këtë marrëveshje bashkëpunimi.

**Neni 7**  
**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe do të qëndroj për një periudhë 10 (dhjetë) vjeçare.
2. Kjo marrëveshje mund të plotësohet dhe ndryshohet me pajtim të palëve përmes komunikimit të shkruar. Amandamentimi do jetë pjesë integrale e marrëveshjes pas nënshkrimit.
3. Çdo mosmarrëveshje krijuar mbi interpretimin ,menaxhimin ose ekzekutimin e kësaj marrëveshje do të zgjidhet me negociata dhe nëse është e nevojshme me anë të ndërmjetësimit ose arbitrazhit. (*"Marrëveshja e Arbitrazhit" nënkupton marrëveshjen e arritur ndërmjet dy ose më shumë personave, që disa ose të gjitha kontestet juridike, të cilat kanë lindur ose që mund të lindin ndërmjet tyre, do t'i nënshtrohen arbitrazhit. Të gjitha mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë me kërkesa civile-juridike dhe ekonomike-juridike mund t'i nënshtrohen arbitrazhit, përveç nëse është e ndaluar me ligj.*)
4. Kjo marrëveshje është hartuar në 2 (dy) kopje origjinale, secila në gjuhën Shqipe dhe Angleze, ku palët nënshkruese marrin nga 1 (një) kopje.

Kjo marrëveshje hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët në marrëveshje.

PËR QYTETIN E GJAKOVËS  
REPUBLIKA E KOSOVËS  
**Ardian Gjini**  
Kryetari Gjakovës

PËR QYTETIN E FORT DODGE  
IOWA, SHIBA  
**Matt Bemrich**  
Kryetar i Fort Dodge